FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 68	**2002**	**Nëntor**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8947 datë 3.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e mirëmbajtjes së rrugëve"…….	1903
Ligj nr. 8948 datë 3.10.2002	Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999……	1914
Ligj nr. 8949 datë 3.10.2002	Për një ndryshim në ligjin nr. 8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 8507, datë 7.7.1999; nr. 8595, datë 6.4.2000; nr. 8716, datë 15.12.2000 dhe nr.8848, datë 19.12.2001	1915
Dekret nr. 3529,	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	1915

datë 30.10.2002	……..	
Vendim i KM nr. 441, datë 26.9.2002	Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve…… ……..	1915
Vendim i KM nr. 504, datë 16.10.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 78, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje", të ndryshuar…… …….	1916
Vendim i KM nr. 506, datë 16.10.2002	Për një shtesë në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore"…….	1916
Vendim i KM nr. 507, datë 16.10.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, e cila preket nga ndërtimi i depos së ujit të pijshëm në bashkinë e Gramshit…….	1917
Vendim i KM nr. 508, datë 16.10.2002	Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar……	1918
Vendim i KM nr. 509, datë 16.10.2002	Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të vitit 2002 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Mbrojtjes…… …….	1919

L I G J
Nr. 8947, datë 3.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e mirëmbajtjes së rrugëve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3511, datë 21.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJA
E KREDISË SË ZHVILLIMIT MIDIS SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

(Projekti i Mirëmbajtjes së Rrugëve)

Marrëveshja e datës 15 korrik 2002 midis Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata);

Ku (A) Huamarrësi, i cili është i kënaqur me bështmërinë dhe prioritetin e Projektit, të përshkruar në seksionin 2 të kësaj Marrëveshjeje, i ka kërkuar Shoqatës të ndihmojë në financimin e Projektit; dhe

Ku Shoqata ka rënë dakord, mbi bazën e sa më sipër, t'i japë një kredi Huamarrësit sipas afateve kohore dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Kështu që, Palët e mësipërme bien dakord si vijon:

Neni 1
Kushtet e përgjithshme; përkufizime

Seksioni 1.01. "Kushtet e përgjithshme të aplikueshme për Marrëveshje të Kredisë së Zhvillimit" të Shoqatës, të datës 1 janar 1985 (dhe amenduar deri në 6 tetor 1999) (Kushtet e përgjithshme), përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02. Vetëm nëse konteksti i fjalisë e kërkon ndryshe, termat e ndryshme të përkufizuara në kushtet e përgjithshme kanë kuptimin përkatës të përcaktuar që këtej e tutje, si dhe termat e tjerë që kanë kuptimin e dhënë më poshtë:

a) "EMP" do të thotë plani i manaxhimit ambiental, i pranueshëm nga Shoqata, i përgatitur dhe aprovuar nga Huamarrësi në 11 mars 2002, dhe që përshkruan masat mbrojtëse ambientale dhe sociale, monitorimin dhe hapat institucionale në kuadrin e Projektit.

b) "FY" do të thotë viti fiskal i Huamarrësit.

c) "Raporti i monitorimit financiar" ose "FMR" janë raportet e përgatitura në përputhje me seksionin 4.02. të kësaj Marrëveshjeje.

d) "GRD" është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve e Huamarrësit, e ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.614, datë 29 dhjetor 1993 "Për themelimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve".

e) "PIP" do të thotë Plani i Zbatimit të Projektit, i aprovuar nga Huamarrësi dhe i pranueshëm për Shoqatën, i cili përcakton procedurat operative dhe administrative për zbatimin e Projektit.

f) "PIU"do të thotë Njësia e Zbatimit të Projektit, e ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të Huamarrësit.

g) "Llogaria e Projektit" është llogaria të cilës i referohemi në seksionin 6.01. (b) të kësaj Marrëveshjeje, e cila mbahet nga Huamarrësi në monedhën lokale dhe që përdoret për të financuar kontributin e Huamarrësit në shpenzimet e Projektit.

h) Dhe "Llogari e veçantë" do të thotë llogaria së cilës i referohemi në seksionin 2.02. të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i huajë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në monedha të ndryshme të barabartë me trembëdhjetë milion e pesëqind mijë të drejta speciale të tërheqjes (SDR 13.500.000)

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose për shpenzimet që do të bëhen, nëse bie dakord Shoqata) në lidhje me kosto të justifikuara të mallrave dhe shërbimeve, të cilat kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga Kredia.

(b) Huamarrësi mundet që, për qëllime të këtij Projekti, të hapë dhe të mbajë në dollarë një llogari depozite të veçantë, duke respektuar afatet dhe kushtet e pranueshme nga Shoqata, duke përfshirë mbrojtjen e duhur nga kompensimi, sekuestrimi dhe pengu. Depozitimet ose pagesat nga llogaria speciale do të bëhen në përputhje me dispozitat e plan-grafikut 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes do të jetë 30 qershor 2007 ose një datë e mëvonshme që do të përcaktohet nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një pagesë të detyruar mbi shumën e Kredisë që nuk është tërhequr herë pas here në një sasi që do të përcaktohet nga Shoqata më datë 30 qershor të secilit vit, por që nuk duhet të kalojë gjysmë për qind (1/2 e 1%) në vit.

(b) Pagesa e detyruar do të maturohet: (i) pas gjashtëdhjetë ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje (data e interesit) deri në datat respektive kur do të tërhiqen ose anulohen nga Huamarrësi shumat nga llogaria e kredisë; dhe (ii) në shumën e caktuar më 30 qershor, menjëherë përpara datës së maturimit apo në sasi të tjera siç mund të caktohen herë pas here në bazë të paragrafit (a) më sipër. Shuma e përcaktuar më 30 qershor të çdo viti do të zbatohet që nga data pasardhëse e atij viti, që përcaktohet në seksionin 2.06. të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Shuma e detyruar do të paguhet: (i) në vende të tilla të kërkuara e të justifikuara nga Shoqata; (ii) pa kufizime të çdo lloji të vendosura nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e përcaktuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e seksionit 4.02. të kushteve të përgjithshme ose në ndonjë monedhë apo monedha të tjera të përshtatshme që mund të caktohen ose përzgjidhen herë pas here në bazë të dispozitave të këtij seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi duhet t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi prej tre të katërtave të njëpërqindshit (3/4 e 1%) në vit mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr dhe të papaguar në një kohë të caktuar.

Seksioni 2.06. Shumat e detyrueshme dhe ato të shërbimit do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. (a) Në bazë të paragrafëve (b), (c) dhe (d) më poshtë, Huamarrësi do të ripaguajë shumën principale të Kredisë me këste gjashtëmujore të pagueshme në çdo 15 prill dhe 15 tetor, duke filluar nga 15 tetori 2012 dhe duke përfunduar në 15 prill 2042. Çdo këst, duke përfshirë kështin e pagueshëm në 15 prill 2022, do të jetë një për qind (1%) e kësaj shume principale dhe çdo

këst i mëvonshëm do të jetë dy për qind (2%) i kësaj shume principale.

(b) Kur: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë (GNP-ja) i Huamarrësit, siç është vendosur nga Shoqata, do të ketë kaluar për tre vjet rresht një nivel vjetor të vendosur nga Shoqata për të përcaktuar nëse i takon të përfitojë nga financimet e Shoqatës; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të përshtatshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata mundet që, pas rishikimit dhe aprovimit nga drejtorët ekzekutivë të Shoqatës dhe pas një periudhe vlerësimi nga ana e tyre të zhvillimit të ekonomisë së Huamarrësit, të modifikojë pagesën e kësteve në bazë të paragrafit (a) më sipër:

(A) duke i kërkuar Huamarrësit të shlyejë dyfishin e shumës të secilit prej këtyre kësteve që nuk janë paguar ende deri kur të paguhet shuma principale e Kredisë; dhe

(B) duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë pagesën e shumës principale të Kredisë që nga data e parë e pagesës gjysmëvjetore për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (a) më sipër, pas gjashtë apo më shumë muajsh pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin që kanë ndodhur ngjarjet e përcaktuara në paragrafin (b), duke pasur parasysh që do të ketë një periudhë faljeje prej një minimumi pesëvjetësh mbi këtë shlyerje të principalit.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më sipër që të përfshijnë disa ose të gjitha rritjet në shumat e kësteve, pagesën e interesit për një tarifë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi shumën principale të Kredisë së tërhequr herë pas here, duke pasur parasysh që në bazë të gjykimit të Shoqatës një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit që është marrë në bazë të modifikimit të mësipërm të shlyerjes.

(d) Nëse në ndonjë moment pas modifikimeve të termave në bazë të paragrafit (b) më sipër, Shoqata vendos që gjendja ekonomike e Huamarrësit është përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme, në rast se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mundet të modifikojë më tej termat e pagesës për të qenë konform skedulit të kësteve siç paraqitet në paragrafin (a) më sipër.

Seksioni 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllimet e seksionit 4.02. të kushteve të përgjithshme.

Neni 3
Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit të përcaktuara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, do të zbatojë Projektin nëpërmjet PIU-t me kujdesin/zellin dhe efikasitetin e duhur, si edhe në përputhje me praktikat e përshtatshme financiare, administrative, mjedisore dhe teknike. Huamarrësi do të sigurojë menjëherë, sipas nevojës, fondet, lehtësitë dhe burimet e tjera të kërkuara nga Projekti.

b) Pa u kufizuar nga dispozitat e paragrafit (a) të këtij seksioni dhe me përjashtim të atyre rasteve kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me programin e zbatimit, të përcaktuar në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me përjashtim të atyre rasteve kur Shoqata bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve, që kërkohen në kuadrin e Projektit dhe që do të financohen nga Kredia, do të qeverisen nga dispozitat e shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e seksionit 9.06. të kushteve të përgjithshme dhe pa u kufizuar me to, Huamarrësi:

(a) përgatit, mbi bazën e udhëzimeve të pranueshme për Shoqatën, dhe i paraqet Shoqatës një plan për funksionimin e ardhshëm të Projektit, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes apo ndonjë datë tjetër për të cilën mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës;

(b) i jep Shoqatës mundësinë për të shkëmbyer mendime mbi këtë plan të Huamarrësit.

Neni 4
Klauzolat financiare

Seksioni 4.01. (a) Huamarrësi duhet të mbajë një sistem të administrimit financiar, i cili duhet të përfshijë regjistrat dhe llogaritë dhe do të përgatisë deklaratat financiare në një format të pranueshëm për Shoqatën, i përshtatshëm për të reflektuar veprimtaritë, burimet dhe shpenzimet e lidhura me Projektin.

(b) Huamarrësi:

(i) do të mbajë regjistrat, llogaritë dhe deklaratat financiare, të cilave u referohet paragrafi (a) i këtij seksioni, si edhe regjistrat dhe llogaritë për llogarinë e veçantë për çdo vit fiskal të revizionuar, në përputhje me standardet e kontroll-revizionimit të pranueshme nga Banka, të aplikuara në mënyrë të qëndrueshme nga revizorë të pavarur të pranueshëm nga Shoqata;

(ii) do t'i paraqesë Bankës sapo të jenë të disponueshme, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit të çdo viti të tillë: (A) kopje të vërtetuara të deklaratave financiare që u referohet paragrafi (a) i këtij seksioni për çdo vit kontroll-revizioni; dhe (B) një opinion mbi këto deklarata, regjistra dhe raporte të kontroll-revizionit nga këta revizorë sipas hollësive të kërkuara, brenda arsyes nga Shoqata, sapo këto të jenë gati, por sidoqoftë jo më vonë se pas gjashtë muajsh nga data e përfundimit të çdo viti të tillë; dhe

(iii) do t'i paraqesë Shoqatës çfarëdolloj informacioni tjetër në lidhje me këto regjistra dhe llogari, si edhe me revizionimin e tyre, si edhe informacion në lidhje me revizorët sa herë që Shoqata ta kërkojë një gjë të tillë.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me tërheqjet nga llogaria e kredisë, në bazë të deklaratës të shpenzimeve, Huamarrësi:

(i) do t'i mbajë apo do të realizojë mbajtjen e regjistrave dhe llogarive të veçanta, që tregojnë këto shpenzime, në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni;

(ii) do të ruajë, për së paku një vit pasi Shoqata të ketë marrë raportin e kontroll-revizionit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e kredisë, të gjitha regjistrat (kontratat, urdhrat, faturat dhe dokumentet e tjera) që vërtetojnë këto shpenzime;

(iii) do t'i mundësojë përfaqësuesit të Shoqatës shqyrtimin e këtyre regjistrave; dhe

(iv) do të sigurohet që këto regjistra dhe llogari të përfshihen në kontroll-revizionin vjetor, të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij seksioni dhe që raporti i këtij kontroll-revizioni të përmbajë një opinion të veçantë nga këta revizorë, nëse deklaratat e shpenzimeve gjatë vitit fiskal në fjalë, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme që janë bërë gjatë përgatitjes së tyre të jenë të besueshme për të mbështetur tërheqjet në fjalë.

Seksioni 4.02. (a) Pa i kufizuar detyrimet raportuese të progresit të Huamarrësit, përcaktuar në seksionin 4.01. të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i kërkoj PIU-t të përgatisë një raport të monitorimit financiar, me formë dhe përmbajtje të pranueshme në Shoqata dhe t'ia paraqesë ato Shoqatës. Secili nga këto raporte:

(i) përcakton burimet faktike dhe aplikimet për fondet e Projektit si në mënyrë kumulative dhe për periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë, që tregojnë në veçanti fondet e siguruara nga Kredia dhe shpjegon ndryshimet midis shfrytëzimit faktik dhe të planifikuar të fondeve;

(ii) përshkruan ecurinë fizike në zbatimin e Projektit si mënyrë kumulative, ashtu edhe për periudhën që mbulon raporti në fjalë, dhe shpjegon ndryshimet/mospërputhjet midis zbatimit të Projektit të planifikuar dhe faktik; dhe

(b) Raporti i parë i administrimit financiar (FMR) i duhet dorëzuar Shoqatës jo më vonë se pas 45 ditësh pas përfundimit të tremujorit të parë kalendarik pas datës kur Kredia bëhet efektive dhe do të mbulojë periudhën që nga shpenzimi i parë i Projektit deri në fund të tremujorit; pas kësaj, çdo raport i administrimit financiar i duhet paraqitur Shoqatës jo më vonë se pas 45 ditësh të tremujorit kalendarik pasardhës dhe do të mbulojë tremujorin kalendarik në fjalë.

Neni 5
Mjetet ligjore të Shoqatës

Seksioni 5.01. Në bazë të seksionit 6.02. (1) të kushteve të përgjithshme, janë specifikuar ngjarjet e mëposhtme, si p.sh. që plani i zbatimit të Projektit do të ndryshohet, pezullohet, shfuqizohet, përfundohet, hiqet apo modifikohet, duke bërë që të ndikojë materialisht dhe me efekt negativ, sipas opinionit të Shoqatës, në realizimin e Projektit.

Seksioni 5.02. Sipas seksionit 7.01. (h) të kushteve të përgjithshme, specifikohet ngjarja e mëposhtme shtesë, d.m.th. që ngjarja e specifikuar në seksionin 5.01. të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë.

Neni 6
Data e hyrjes në fuqi; përfundimi

Seksioni 6.01. Ngjarjet e mëposhtme janë përcaktuar si kushte shtesë për hyrje në fuqi të Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit brenda kuptimit të seksionit 12.01. (b) nga kushtet e përgjithshme që Huamarrësi të ketë hapur një llogari të Projektit në një bankë tregtare me terma dhe kushte të pranueshme për Shoqatën me një depozitë fillestare në monedhë vendase prej 300,000 USD.

Seksioni 6.02. Dita nëntëdhjetë (90) ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar këtu më poshtë për qëllimet e seksionit 12.04. të kushteve të përgjithshme.

Neni 7
Përfaqësuesi i Huamarrësit; adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03. të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 11.01. të kushteve të përgjithshme.

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë
Shqipëri
Faksimile: 355 4 228 494

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C.20433
United States of America
Cable address: INDEVAS
Washington, D.C.
Teleks: 248423 (MCI) ose 64145 (MCI)
Faksimile: (202) 477-6391

Në prani të dëshmitarëve, Palët e mësipërme, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kanë firmosur në emrat e tyre përkatës në Distriktin e Kolumbias në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ditës dhe vitit që është shkruar më sipër.

Shqipëria
Nga:/s/Z.Fatos Tarifa
Përfaqësues i autorizuar

Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
Nga:/s/Kathryn Ann Funk
Përfaqësuesi i Autorizuar

Plan-Grafiku 1
Tërheqjet nga Kredia

1. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e njësive që do të financohen nga Kredia, shpërndarjen e shumave të Kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për çdo njësi që do të financohet nga secila kategori:

Kategoria	Shuma e kredisë (shprehur në ekuivalent të SDR-së)	% e shpenzimeve për t'u financuar
(1) Punime	10,600,000	80%
(2) Mallra a) sipas pjesës B(3) të Projektit sipas pjesëve A, B (1), (2) dhe (4) të Projektit	200,000 400,000	100% e shpenzimeve të huaja, 100%e shpenzimeve lokale (kostoja ex-factory) dhe 80% e shpenzimeve lokale për njësi të tjera të prokuruara në vend
(3) Shërbimet e konsulentëve, trajnimi dhe revizionimi	2,300,000	85%

Gjithsej	13,500,000	

2. Për qëllimet e këtij plan-grafiku:

(a) termi "shpenzime të huaja" ka kuptimin shpenzime në monedhën e çdo vendi, përveç asaj të Huamarrësit për mallra apo shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi, me përjashtim të atij të Huamarrësit; dhe

(b) termi "shpenzime lokale" ka kuptimin shpenzime në monedhën e Huamarrësit për mallra a shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit (1) më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për: (a) pagesa për shpenzime që janë bërë përpara datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe (b) pagesa të bëra sipas kategorisë (2) (a), nëse Shoqata nuk ka marrë një plan të pranueshëm për shfrytëzimin e pas, metodat dhe procedurat e përdorimit dhe ndryshimet organizative dhe operative të nevojshme për përdorimin efektiv të tyre.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërhqjet nga llogaria e kredisë të bëhen në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzime në lidhje me: (a) mallra sipas kontratave që kushtojnë më pak se ekuivalenti i 100,000 dollarë secila; (b) punime në bazë të kontratave që kushtojnë më pak se ekuivalenti i 100,000 dollarë secila; (c) shërbime dhe trajnime për firma konsulente, kontratat e të cilave kushtojnë më pak se ekuivalenti i 100,000 dollarë secila; (d) kontrata për individ konsulentë që kushtojnë më pak se ekuivalenti i 50,000 dollarë secila, sipas afatave dhe kushteve të specifikuara nga Shoqata me njoftim që do t'i bëjë Huamarrësit.

Plan - grafiku 2
Përshkrim i Projektit

Objektivi i Projektit është përmirësimi i cilësisë, mirëmbajtjes dhe sigurisë së rrjetit rrugor të Huamarrësit.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, të cilat mund të ndryshohen me anë të Marrëveshjes midis Huamarrësit dhe Shoqatës për çdo rast, për arritjen e këtyre objektivave:

PJESA A:
MIRËMBAJTJA E RRJETIT RRUGOR

1. Mirëmbajtja dhe riparimi i rreth 500 km të rrugëve kombëtare dhe urave, të përzgjedhura në përputhje me kriterin e përzgjedhjes nga Shoqata.

2. Mirëmbajtja dhe riparimi i rreth 500 km të rrugëve rurale dhe urave, të përzgjedhura në përputhje me kriterin e përzgjedhjes nga Shoqata.

3. Forcimi i kapaciteteve të Huamarrësit për një administrim më efektiv të Projektit nëpërmjet: (a) sigurimit të pajisjeve, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për administrimin më të mirë të rrugëve, urave dhe zbatimin e bankës së të dhënave rrugore; dhe (b) sigurimi i shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit për të mbështetur PIU-n në prokurimet dhe zbatimet.

PJESA B:
PËRMIRËSIMI I SIGURISË SË TRAFIKUT

Sigurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulencës dhe trajnimi për: (1) përmirësimin e pikave të aksidenteve; (2) instalimi i pajisjeve të kontrollit të trafikut; (3) sigurimi i pajisjeve për zbatimin e sigurisë rrugore dhe të pajisjeve të emergjencës, si pajisje të kontrollit të shpejtësisë me laser/ose radar, për frymëmarrjen, aparate për matjen e tensionit, kuti të ndihmës së shpejtë, si dhe programe kompjuteri për databazën e aksidenteve; dhe (4) forcimi i kapacitetit institucional të Huamarrësit për të monitoruar dhe administruar aktivitetet e sigurisë së trafikut.

Projekti pritet të përfundojë në 31 dhjetor 2006.

PLAN -GRAFIKU 3
PROKURIMI DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni I: Prokurimi i mallrave dhe punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me: (a) dispozitat e seksionit I të materialit "Udhëzime për prokurimin sipas huave të IBRD-së dhe kredive të IDA-s", botuar nga Banka në janar 1995 dhe rishikuar në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999 (Udhëzimet) dhe dispozitat e pjesëve vijuese të seksionit I.

PJESA B:
TENDERI NDËRKOMBËTAR

1. Përveç asaj që parashikohet ndryshe, në pjesën C të këtij seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e seksionit II të udhëzimeve dhe paragrafit 5 të shtojcës 1 të tyre.

2. Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për mallrat dhe punimet, të cilat duhet të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të kësaj pjese B.

Preferenca për mallrat e prodhuara në vend

Dispozitat e paragrafëve 2.54. dhe 2.55. të udhëzimeve dhe shtojcës 2 të tyre do të zbatohen për mallrat e prodhuara në territorin e Huamarrësit.

PJESA C:
PROCEDURA TË TJERA PROKURIMI

1. Tenderi kombëtar

Të përgjithshme

Mallrat që llogaritet të kushtojnë më pak se ekuivalenti $ 1,000,000 për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë ekuivalentin $ 9,000,000, mund të blihen (prokurohen) sipas kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve.

Përmirësimi i procedurave të tenderit

Me qëllim që të sigurohet efekti ekonomik, transparenca, eficenca dhe një përputhje e gjerë me dispozitat e seksionit 1 të udhëzimeve:

(i) Ftesat për tender duhet të publikohen te të paktën një gazetë vendase me shitje të madhe, të paktën 30 ditë para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave.

(ii) Parakualifikimi duhet të kryhet për punime të mëdha ose të specializuara.

(iii) Në dokumentet e parakualifikimit duhet të jepet qartë eksperienca minimale e kërkuar, kërkesat financiare dhe teknike ose, në raste paskualifikimi, ato duhet të paraqiten në dokumentet e tenderit.

(iv) Ofertuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga tenderi dhe ofertat e vendasve nuk do të jenë të preferuara gjatë procesit të tenderit. Ndërmarrjeve shtetërore në Shqipëri do t'u lejohet të marrin pjesë në tender vetëm nëse janë autonome nga ana ligjore dhe financiare dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjeve tregtare të Huamarrësit.

(v) Entet e prokurimit duhet të përdorin dokumente prokurimi standarde për rajonin (NCB), të aprovuara nga Banka përpara shpërndarjes së tyre pjesëmarrësve në tender.

(vi) Ofertat duhet të hapen në të njëjtin vend në publik, menjëherë pas përfundimit të afatit të dorëzimit, në prani të përfaqësuesve të ofertuesve.

(vii) Për dorëzimin e ofertave do të ndiqet procedura e një zarfi të vetëm.

(viii) Kur parakualifikimi nuk është bërë, paskualifikimi do t'i bëhet vetëm ofertës më të ulët të vlerësuar; në momentin e hapjes së ofertave, asnjë ofertë nuk do të refuzohet duke marrë parasysh kualifikimin.

(ix) Pjesëmarrësit në tender, të cilët kontraktojnë si ndërmarrje e përbashkët, do të konsiderohen së bashku përgjegjës.

(x) Pjesëmarrësve në tender do t'u kërkohet të dorëzojnë ofertën dhe sigurimin e ofertës me një shumë të përafërt me atë të kontratës dhe në një formë të pranueshme nga Huamarrësi.

(xi) Kontrata duhet të lidhet me pjesëmarrësin në tender me ofertën më të ulët të vlerësuar, thelbësisht të përgjegjshëm, i vendosur të kualifikohet për të vepruar në përputhje me kriteret e parapërkufizuara dhe parashpallura të vlerësimit.

(xii) Dhe kontratat me afat të gjatë (më tepër se 18 muaj) duhet të përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimeve.

2. Blerjet ndërkombëtare

Mallrat që llogaritet të kushtojnë më pak se ekuivalenti i $ 100,000 për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë vlerën e ekuivalentit $ 280,000 mund të blihen (prokurohen) sipas kontratave të lidhura në bazë të procedurave ndërkombëtare të blerjeve, në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

3. Prokurimi i punimeve të vogla

Punimet që llogaritet të kushtojnë më pak se ekuivalenti i $ 100,000 për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që të mos e kalojë vlerën e ekuivalentit $ 1,200,000, mund të blihen (prokurohen) të gjitha njëherësh, me kontrata me çmim fiks të lidhura në bazë të kuotimit të marrë nga 3 (tre) kontraktorë vendas të kualifikuar, në përgjigje të një ftese të shkruar. Ftesa duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të punimeve, përfshirë këtu specifikimet bazë, datën e përfundimit, formën bazë të Marrëveshjes të pranueshme nga ana e Shoqatës dhe skica, aty ku është e nevojshme. Do të lidhet kontrata me kontraktorin që ofron çmimin më të ulët për punën e kërkuar, i cili ka përvojën dhe burimet për ta përfunduar me sukses kontratën.

PJESA D:
KONTROLLI NGA SHOQATA I VENDIMEVE TË PROKURIMIT

1. Planifikimi i prokurimit

Para nxjerrjes së ftesës për organizim tenderi kontratash, plani i propozuar i prokurimit për Projektin do t'i paraqitet Shoqatës për rishikim dhe miratim, sipas dispozitave të paragrafit 1 të shtojcës 1 të udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të ndërmerret në përputhje me planin e prokurimeve që do të miratohet nga Shoqata dhe dispozitat e paragrafit 1 të sipërpërmendur.

2. Rishikimi paraprak

(a) Në lidhje me çdo kontratë për vlerën e ekuivalentit $100,000 ose më shumë, që do të prokurohet në përputhje me procedurën e përmendur në pjesën B.1 dhe C.1 të këtij plan-grafiku, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 2 dhe 3 të shtojcës 1 të udhëzimeve.

(b) Në lidhje me çdo kontratë që do të prokurohet në përputhje ne procedurën e përmendur në pjesën C.3 të këtij seksioni, do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

(i) Përpara zbatimit të çdo kontrate në bazë të procedurave të blerjes, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një raport të krahasimit dhe vlerësimit të kuotimeve të marra.

(ii) Përpara zbatimit të çdo kontrate në bazë të procedurave të blerjes, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një kopje të specifikimeve dhe draftkontratës.

(iii) Dhe do të zbatohen procedurat e përmendura në paragrafët 2(f), 2(g) dhe 3 të shtojcës 1 të udhëzimeve.

3. Rishikimi i mëpasëm

Në lidhje me çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj pjese, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 4 të shtojcës 1 të udhëzimeve.

Seksioni II: Pajtimi i konsulentëve

Pjesa A: Të përgjithshme

Shërbimet e konsulencës do të prokurohen në përputhje me: (a) dispozitat e hyrjes dhe të seksionit 4 të "Udhëzime: përzgjedhja dhe pajtimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", botuar nga Organizata në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999, në varësi të ndryshimeve të bëra të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj pjese A (Udhëzime për konsulentët) dhe (b) dispozitat e pjesëve vijuese të këtij seksioni II.

PJESA B:
PËRZGJEDHJA SIPAS CILËSISË DHE KOSTOS

Përveç rasteve që parashikohet ndryshe në pjesën C të këtij seksioni, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e seksionit II të udhëzimeve për konsulentët, paragrafi 3 i shtojcës 1 të tyre, shtojcës 2 të tyre dhe dispozitat e

paragrafëve 3.13 deri në 3.18 të tyre, të zbatueshme për përzgjedhjen e konsulentëve sipas cilësisë dhe kostos.

PJESA C:
PROCEDURA TË TJERA PËR PËRZGJEDHJEN E KONSULENTËVE

1. Përzgjedhja bazuar në kualifikimet e konsulentit

Shërbimet për trajnimet dhe organizimin e seminareve që parashikohen të kushtojnë më pak se ekuivalenti $100,000 për kontratë, mund të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.1 dhe 3.7 të udhëzimeve për konsulentët.

2. Konsulentët individualë (të veçantë)

Shërbimet për trajnime dhe asistencë teknike ndaj PIU-t do të prokurohen në bazë të kontratave të lidhura me konsulentë të veçantë (individualë), në përputhje me dispozitat e paragrafëve 5.1 deri në 5.3 të udhëzimeve për konsulentët.

PJESA D:
RISHIKIMI NGA SHOQATA I PËRZGJEDHJES SË KONSULENTËVE

1. Planifikimi i përzgjedhjes

Para publikimit te konsulentët të kërkesës për ofertë, plani i propozuar për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të Projektit do t'i paraqitet Shoqatës për kontroll dhe miratim, sipas dispozitave të paragrafit 1 të shtojcës 1 të udhëzimeve për konsulentët. Përzgjedhja e shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me planin e përzgjedhjes që do të miratohet nga Shoqata dhe me dispozitat e paragrafit 1 të sipërpërmendur.

2. Rishikimi paraprak

(a) Në lidhje me çdo kontratë për pajtimin e firmave të konsulentëve, që llogaritet të kushtojë sa ekuivalenti $100,000 ose më shumë, do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 5 të shtojcës 1 të udhëzimeve për konsulentët (jo nënparagrafi i tretë i paragrafit 2 (a).

(b) Në lidhje me çdo kontratë për pajtimin e konsulentëve të veçantë (individualë), që llogaritet të kushtojë sa ekuivalenti $50,000 ose më shumë, kualifikimet, përvoja, termat e referencës dhe kushtet e pajtimit të konsulentëve do t'i paraqiten Shoqatës për rishikim dhe miratim paraprak. Kontrata do të lidhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i mësipërm.

3. Rishikimi i mëpasëm

Në lidhje me çdo kontratë që nuk mbulohet nga paragrafi 2 i kësaj pjese do të zbatohen procedurat e parashikuara në paragrafin 4 të shtojcës 1 të udhëzimeve.

Plan-grafiku 4

Programi i zbatimit

1. Huamarrësi:

(a) duhet të zbatojë politika dhe procedura të përshtatshme për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin nga ana e tij në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me tregues të pranueshëm për Shoqatën, zbatimin e Projektit dhe realizimin e objektivave të tij;

(b) duhet të përgatisë, në bazë të termave të referencës të pranueshme nga Shoqata, dhe t'i paraqesë asaj rreth datës 31 gusht 2004 një raport që përmbledh rezultatet e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni mbi ecurinë e arritur në realizimin e Projektit gjatë periudhës deri në datën e raportit të sipërpërmendur dhe përcakton masat e rekomanduara për të siguruar realizimin me efektivitet të Projektit dhe realizimin e objektivave të tij gjatë periudhës në vijim (pas datës së raportit); dhe

(c) duhet të rishikojë me Shoqatën, deri në 30 shtator 2004 ose në atë datë të mëvonshme që do të kërkohet nga Shoqata, raportin të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij seksioni dhe, pas kësaj, të marrë të gjitha masat në mënyrë që të sigurojë përfundimin me sukses të Projektit dhe realizimin e objektivave të tij, duke u bazuar në përfundimet dhe rekomandimet e raportit të mësipërm dhe, gjithashtu, në mendimet e Shoqatës për këtë çështje.

2. Huamarrësi duhet të marrë ose të bëjë të mundur marrjen e të gjitha masave të nevojshme për realizimin e EMP-së në kohën e caktuar.

3. Huamarrësi duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Shoqatës programin vjetor të zbatimit dhe

buxhetin për Projektin brenda datës 30 nëntor të çdo viti.

4. Huamarrësi duhet të rrisë, deri në përfundim të Projektit, planifikimin dhe alokimin e fondeve vjetore për GRD-në për mirëmbajtjen e rrugëve, të paktën 5% çdo vit, duke filluar nga niveli i vitit financiar 2001.

5. Në zbatim të seksionit 9.08. të kushteve të përgjithshme, Huamarrësi do të sigurojë që gjithë shpronësimi i tokës që nevojitet për pjesën B të Projektit të jetë në përputhje me procedurat e kompensimit dhe zëvendësimit të aprovuar nga Shoqata.

6. Huamarrësi, brenda datës 30 qershor 2003, duhet të rregullojë taksën për benzinën me dhe pa plumb, me qëllim që mesatarja e çmimit të pakicës të benzinës me plumb të jetë të paktën 5% më e lartë se mesatarja e çmimit të pakicës të benzinës pa plumb.

PLAN-GRAFIKU 5
LLOGARIA E VEÇANTË

1. Për qëllimet e kësaj shtojce:

(a) Termi "Kategori e pranueshme" do të thotë kategori (1), (2) dhe (3) të përcaktuara në tabelë në paragrafin 1 të plan-grafikut 1 të kësaj Marrëveshje.

(b) Termi "Shpenzime të pranueshme" do të thotë shpenzime në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara nga Projekti dhe të financuara jashtë Kredisë së akorduar në mënyrë të herëpashershme kategorive të pranueshme, në përputhje me (në bazë të) dispozitat e plan-grafikut 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Dhe termi "Shumë e autorizuar" do të thotë një shumë e barazvlefshme me ekuivalentin $1,000,000, e cila duhet të tërhiqet nga llogaria e kreditimit dhe të depozitohet në llogarinë e veçantë në zbatim të paragrafit 3 (a) të këtij plan-grafiku por, me kusht që Shoqata nuk bie dakord ndryshe, shuma e autorizuar të kufizohet deri në ekuivalent $ 500,000, derisa shuma progresive e tërheqjeve nga llogaria e kreditimit, plus shumën e përgjithshme të të gjitha angazhimeve të veçanta në të cilat ka hyrë Shoqata në zbatim të seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme, të jetë e barabartë me ekuivalentin prej SDR 2,500,000 ose ta kalojë atë.

2. Pagesat nga llogaria e veçantë do të bëhen vetëm për shpenzime të pranueshme, në përputhje me dispozitat e këtij plan-grafiku.

3. Pasi Shoqata të ketë evidenca të kënaqshme që llogaria e veçantë është hapur në kohën e duhur, tërheqjet e shumës së autorizuar dhe ato të mëpasshme për të plotësuar llogarinë e veçantë duhet të bëhen si më poshtë:

(a) Për tërheqjen e shumës së autorizuar, Huamarrësi duhet t'i bëjë Shoqatës një kërkesë ose disa kërkesa për depozitim në llogarinë e veçantë të një shume ose disa shumave, të cilat në total nuk e kalojnë shumën e autorizuar. Mbi bazën e çdo kërkese të këtij lloji, Shoqata do të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë e veçantë atë shumë ose ato shuma që do të ketë kërkuar Huamarrësi.

(b) (i) Për të plotësuar llogarinë e veçantë, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës kërkesa për depozitimin në llogarinë e veçantë në ato intervale që do të specifikohet nga Shoqata.

(ii) Para ose në kohën që bëhet secila prej këtyre kërkesave, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës dokumentacionin dhe të gjitha evidencat e kërkuara në zbatim të paragrafit 4 të këtij plan-grafiku për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat kërkohet plotësimi i llogarisë së veçantë. Në bazë të secilës prej këtyre kërkesave, Shoqata duhet të tërheqë, në emër të Huamarrësit, nga llogaria e kredisë dhe të depozitojë në llogarinë e veçantë ato shuma që mund të ketë kërkuar Huamarrësi, të cilat duhet të jenë treguar se janë paguar nga llogaria e veçantë për shpenzime të pranueshme me anë të dokumentacionit dhe evidencave të mësipërme. Secila prej këtyre derdhjeve në llogarinë e veçantë do të tërhiqet nga Shoqata nga llogaria e kredisë sipas një ose më shumë kategorive të pranueshme, në përputhje me shumat ekuivalente të treguara nga dokumentacioni dhe evidencat e mësipërme.

4. Për secilën pagesë që Huamarrësi ka bërë jashtë llogarisë së veçantë, Huamarrësi duhet t'i paraqesë Shoqatës dokumentacionin dhe evidenca të tjera, të cilat të tregojnë që këto pagesa janë bërë vetëm për shpenzime të pranueshme, në çdo kohë që do ta shohë të arsyeshme Shoqata.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3 të këtij plan-grafiku, Shoqatës nuk do t'i kërkohet të vazhdojë depozitimin në llogarinë e veçantë në ato raste kur:

(a) në çdo kohë, në rast se Shoqata do të ketë vendosur që çdo tërheqje e mëtejshme të bëhet

nga Huamarrësi drejtpërsëdrejti nga llogaria e kreditimit, në përputhje me dispozitat e artikullit V të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02. të kësaj Marrëveshje;

(b) Huamarrësi nuk do t'i ketë paraqitur Shoqatës brenda periudhës së specifikuar në seksionin 4.01. (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, asnjë nga raportet e kontrollit financiar, të cilat duhet t'i dorëzohen Shoqatës në zbatim të seksionit të përmendur në lidhje me kontrollin financiar (auditimin) të rakordimeve dhe llogarive për llogarinë e veçantë;

(c) në çdo kohë, në rast se Organizata do ta ketë njoftuar Huamarrësin për qëllimin e saj për pezullimin, totalisht ose pjesërisht, të së drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e kreditimit në zbatim të dispozitave të seksionit 6.02. të kushteve të përgjithshme; ose

(d) në momentin që shuma e patërhequr e kreditit që i takon kategorive të pranueshme minus shumën e përgjithshme të angazhimeve të veçanta të marra nga Shoqata në zbatim të seksionit 5.02. të kushteve të përgjithshme që i aplikohet Projektit, do të jetë e barabartë me dyfishin e ekuivalentit të shumës së autorizuar.

Që këtej, tërheqja nga llogaria e kreditimit e shumës së mbetur patërhequr të kreditit të kategorive të pranueshme do të ndjekë ato procedura që do të specifikojë Shoqata dhe për të cilat do të njoftojë Huamarrësin. Këto tërheqje të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe në masën që Shoqata do të jetë e kënaqur, që të gjitha këto shuma të mbetura në depozitë në llogarinë e veçantë që nga data e këtij njoftimi do të përdoren për të kryer pagesa të pranueshme.

6. (a) Nëse, në çdo moment, Shoqata do të vendosë që çdo pagesë e bërë nga llogaria e veçantë: (i) është bërë për një shpenzim që nuk është shpenzim i pranueshëm ose për një shumë jo të pranueshme në zbatim të paragrafit 2 të këtij plan-grafiku; ose (ii) nuk është justifikuar në bazë të evidencave të dhëna Shoqatës; atëherë Huamarrësi duhet që, sapo të marrë njoftimin nga Shoqata: (A) të paraqesë dokumentet shtesë që mund të kërkohen nga ajo; ose (B) të depozitojnë në llogarinë e veçantë (ose, nëse Shoqata do t'i kërkojë, ta rifinancojë Shoqatën) një shumë të barabartë me shumën e kësaj pagese, që nuk është konsideruar e pranueshme ose e justifikueshme. Në rast se Shoqata nuk bie dakord ndryshe, në llogarinë e veçantë nuk do të bëhet asnjë depozitim tjetër nga Shoqata derisa Huamarrësi të paraqesë këto dokumente ose të bëjë këtë depozitim ose rifinancim sipas rastit.

(b) Nëse, në çdo moment, Shoqata do të vendosë që të mos kërkohet një shumë shtesë në llogarinë e veçantë për të mbuluar pagesat për shpenzime të pranueshme, Huamarrësi duhet që menjëherë pas marrjes së këtij vendimi nga Shoqata, të rifinancojë Shoqatën me këtë shumë të zbuluar.

c) Duke njoftuar Shoqatën, Huamarrësi mund ta financojë atë me të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozituara në llogarinë e veçantë.

(d) Rifinancimet për Shoqatën, të kryera në zbatim të paragrafit 6 (a), (b) dhe (c) të këtij seksioni, do t'i kreditohen llogarisë së kreditimit për tërheqje të mëpasshme ose për anulim në pajtim me dispozitat respektive të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë edhe kushtet e përgjithshme.

L I G J
Nr. 8948, datë 3.10.2002

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 8087, DATË 13.3.1996 "PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE TË SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8521, DATË 30.7.1999

Në mbështetje të nenit 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8087 datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 19/1 të këtij ligji, pas shprehjes "… nxjerrë në lirim…" hiqet shprehja "…për braktisje detyre, si dhe ata që…" dhe në vend të saj vendoset shprehja "…për shkak se...".

Këtij neni i shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:

"Ushtarakët, që nuk kanë përfituar nga ky ligj për shkak të nenit 19/1 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror", ndryshuar në ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999, të cilët nuk janë dënuar me burg me vendim gjyqësor të formës së prerë për krime ushtarake, përfitojnë të drejtën e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve, nga çasti i lindjes së të drejtës për përfitim".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3515, datë 23.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8949, datë 3.10.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8437, DATË 28.12.1998 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 8507, DATË 7.7.1999, NR. 8595, DATË 6.4.2000, NR. 8716, DATË 15.12.2000 DHE NR. 8848, DATË 19.12.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 3, në paragrafin e parë pas shkronjës "F" të ligjit nr. 8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 8507, datë 7.7.1999, nr. 8595, datë 6.4.2000, nr. 8716, datë 15.12.2000 dhe nr. 8848, datë 19.12.2001, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Përjashtohen nga akciza kodet 27.10.0081, 27.10.0083 dhe 27.10.0085 të "Nomenklaturës së mallrave dhe tarifave doganore"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3512, datë 21.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

D E K R E T
Nr. 3529, datë 30.10.2002

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës dhe të nenit 20 dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të saj:

Shqipe Miftar Zogiani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr. 441, datë 26.9.2002

PËR NDALIMIN E MENJËHERSHËM TË VEPRIMTARISË SË SHFRYTËZIMIT TË RËRËS DHE ZHAVORRIT NË SHTRETËRIT E LUMENJVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e të gjithë lumenjve.
2. Çmontimin e të gjithë impianteve të thyerjes e të fraksionimit të zhavorrit që nxirret nga shtretërit e lumenjve deri më datë 31.12.2002.
3. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës të shqyrtojë me përparësi kërkesat për pajisjen me leje shfrytëzimi të gurit gëlqeror të subjekteve, të cilave u ndalohet veprimtaria e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve.
4. Ngarkohen Këshilli Kombëtar i Ujit, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Industrisë dhe Enegjetikës, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 504, datë 16.10.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 21.1.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN E PRONËSISË SHTETËRORE NË DISA SHOQËRI TREGTARE DHE NDËRMARRJE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 78, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e pikës 1 që i bashkëlidhet vendimit, emërtesa "Petrolimpeks", sh.a. Tiranë, në të cilën ruhet pronësia shtetërore në kapitalin prej 51 për qind të aksioneve, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 506, datë 16.10.2002

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, në listën e pikës 1, që i bashkëlidhet vendimit, pas numrit rendor 64 shtohet numri 65 "Parku i udhëtarëve", sh.a. Shkodër, i cili hiqet nga lista e pikës 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 78, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 507, datë 16.10.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, E CILA

PREKET NGA NDËRTIMI I DEPOS SË UJIT TË PIJSHËM NË BASHKINË E GRAMSHIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit Dylber Ali Mema, që preket nga ndërtimi i depos së ujit të pijshëm në bashkinë e Gramshit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Gramshit.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2 255 m2 truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 728 550 (dy milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Investime dhe shpronësime", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 89 000 (tetëdhjetë e nëntë mijë) lekësh, në ngarkim të bashkisë së Gramshit, kërkuesit për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë më 1 nëntor dhe të përfundojë brenda datës 15 nëntor 2002.

7. Punimet për ndërtimin e depos së ujit të pijshëm në qytetin e Gramshit të fillojnë më 15.11.2002 dhe të përfundojnë më 30.11.2003.

8. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga bashkia e Gramshit.

9. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, prefektura e qarkut të Elbasanit dhe bashkia e Gramshit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA EMËRORE E PERSONIT QË DO TË SHPRONËSOHET PËR NDËRTIMIN E DEPOS SË UJIT TË PIJSHËM NË BASHKINË E GRAMSHIT

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi Lek/m2	Vlera në lekë
1	Dylber Ali Mema	2 255	1 210	2 728 550
	Shuma	2 255	1 210	2 728 550

V E N D I M
Nr. 508, datë 16.10.2002

PËR RRITJEN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpërblimi i veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i

përcaktuar në vendimin nr. 190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave "Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar"", i ndryshuar, rritet në masën 3.56 për qind.

Konkretisht:

- Shpërblimi sipas shkonjës "a" të pikës 7, nga 2 837 lekë në muaj bëhet 2 937 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas shkronjës "b" të pikës 7, nga 2 270 lekë në muaj bëhet 2 352 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas shkronjës "c" të pikës 7, nga 1 891 lekë në muaj bëhet 1 958 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas shkronjës "e" të pikës 7, nga 567 lekë në muaj bëhet 587 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 8/1, mbi 6 muaj, nga 945 lekë në muaj bëhet 979 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 8/2 deri në 6 muaj, nga 567 lekë në muaj bëhet 587 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas shkronjës "a" të pikës 9, nga 2 837 lekë në muaj bëhet 2 937 lekë në muaj, plus masën e shpërblimit të invalidit të grupit të parë.
- Shpërblimi sipas shkronjës "b" të pikës 9, nga 1 890 lekë në muaj bëhet 1 958 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 11, nga 945 lekë në muaj bëhet 979 lekë në muaj.
- Shpërblimi sipas pikës 13, nga 37 830 lekë bëhet 39 177 lekë.

2. Fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, miratuar në buxhetin e vitit 2002.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 509, datë 16.10.2002

PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE TË VITIT 2002 NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE NË MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 të neneve 24 e 29 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të nenit 14 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002" dhe të neneve 4 e 20 të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut" me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nga buxheti i miratuar për vitin 2002, në zërin "Pagesat e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut", t'i pakësohet fondi prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh.

2. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, t'i shtohet ky fond prej

2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh për shpenzimet administrative të Komisionit Qendror të statusit të Dëshmorit të Atdheut.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 2. 11. 2002
Doli nga shtypi më 4. 11. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë